



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 182**

**dhjetor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 936, datë 26.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	10789
Vendim i KM nr. 937, datë 26.12.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Orikum, të qarkut të Vlorës.....	10790
Vendim i KM nr. 938, datë 26.12.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Finiq, të qarkut të Vlorës.....	10791
Vendim i KM nr. 940, datë 26.12.2012	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të mjediseve dhe sipërfaqes 2735 m <sup>2</sup> , nga trualli funksional i pronës nr. 100, me emërtim “Grup Depo Rep. Usht. nr. 5011/25”, Tujan, Tiranë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	10793
Vendim i KM nr. 941, datë 26.12.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gjocaj, të qarkut të Elbasanit.....	10798
Vendim i KM nr. 942, datë 26.12.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Tërthore, të qarkut të Kukësit.....	10799

Urdhër i MB nr. 382, datë 31.12.2012	Për delegim kompetencash.....	10800
Vendim i GJK nr. 60, datë 28.12.2012	Me objekt shfuqizimin, si i papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2011-125, datë 8.3.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	10800
Vendim i KSHNJ nr. 25, datë 24.12.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 3, datë 25.6.2011 të Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike “Për miratimin e formularit të kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dhe dokumentet që duhet t’i bashkëngjiten formularit tip të kërkesës”.....	10803
Vendim i ERRU nr. 30, datë 7.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”.....	10804
Vendim i ERRU nr. 33, datë 11.12.2012	Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës Gramsh.....	10805
Vendim i ERRU nr. 34, datë 11.12.2012	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. Ujësjellës Përmet.....	10805
Vendim i ERRU nr. 35, datë 11.12.2012	Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogzhinë....	10806
Vendim i ERRU nr. 36, datë 17.12.2012	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Fier.....	10806
Vendim i ERRU nr. 37, datë 21.12.2012	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Gjirokastër qytet.....	10807
	Kërkesë për shpallje të vdekur të shtetasit Qemal Beshiri.....	10808

**VENDIM**  
**Nr. 936, datë 26.12.2012**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES  
TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1 dhe 23 pika 3 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “A” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, shtohen personat e renditur në listën “a” “Lista e shtuar e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

2. Nga lista e shkronjës “A” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë, me talibanët”, çregjistrohen personat e renditur në listën “b” “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

3. Në fund të shkronjës “B” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”, shtohen kompanitë e renditura në listën “c” “Lista e shtuar e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për talibanët.

4. Në fund të shkronjës “C” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, shtohen personat e renditur në listën “d” “Lista e shtuar e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

5. Nga lista e shkronjës “C” “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen personat e renditur në listën “e” “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë, me organizatën Al-Qaida””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida, me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

6. Nga lista e shkronjës “D” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen kompanitë e renditura në listën “f” “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si kompani të çregjistruara me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



- a) Lista e shtuar e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët:
  1. ABDUL RAUF: ZAKIR;
- b) Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”:
  1. TAHIS;
  2. ABDUL WASAY: MU’TASIM: AGHA;
- c) Lista e shtuar e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët:
  1. HAQQANI NETWORK (HQN);
- d) Lista e shtuar e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida:
  1. AYYUB: BASHIR;
  2. AAMIR: ALI: CHAUDHRY;
- e) Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”:
  1. ALI: MOHAMED: ELHEIT;
  2. LOTFI: BEN ABDUL HAMID: BEN ALI: AL-RIHANI;
  3. AHMED: EL BOUHALI;
  4. FAZUL: ABDULLAH: MOHAMMED;
  5. ABDULLAHI: HUSSEIN: KAHIE;
  6. YASIN: ABDULLAH: EZZEDINE: QADI;
- f) Lista e të çregjistruarve nga “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”:
  1. AL-QAIDA IN THE ARABIAN PENINSULA (AQAP).

#### VENDIM

Nr. 937, datë 26.12.2012

### **PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË ORIKUM TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Orikum të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Orikum të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr. 1026, datë 15.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Orikum të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Orikum për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

Bashkia Orikum, Vlorë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
462-469, 481, 1578	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
470-476	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
480, 2611	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
1535-1537, 2427-2428	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
1539	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
2184	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
661-747, 749-1092, 1094-1357	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim Nuk transferohet sip. 231.6 ha ku 29.59 ha janë në bashkinë Orikum dhe 194.44 ha janë në fshatin Radhimë, pasi nga DAMT-ja e qarkut Vlorë dhe ZMMT-ja e bashkisë Orikum, i është dorëzuar AKKP-së
748, 1894-2163, 2167, 2181, 2188, 2197-2199, 2347, 2351-2352, 2391-2393, 2397, 2401, 2406-2407, 2413-2418, 2422-2426, 2429-2431, 2452, 2456-2457, 2461, 2463-2465, 2469, 2473, 2475, 2488, 2533-2534, 2609, 2626, 1750, 1790, 1819-1832, 1840-1858, 1863-1886 (vetëm kanale të treta) 526-539	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)  Objekte bujqësore	Në pronësi
1465, 1538, 1622, 1711, 1718, 1722, 2338-2341, 2343, 2361-2363, 2365-2367, 2370-2373, 2375-2376, 2421, 2458, 2462, 2467-2468, 2478, 2484, 2486, 2499-2500, 2503-2504, 2510, 2520-2521, 2526-2529, 2599, 2610, 2618, 2624-2625, 2629-2633, 2635-2654	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
2923-2925	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
2404, 2536-2542, 2619, 2634	Varrezat publike	Në pronësi

## VENDIM

Nr. 938, datë 26.12.2012

### PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS FINIQ TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Finiq të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Finiq të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr. 1171, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Finiq të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Finiq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Finiq

Lidhja nr. 1

<b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b>	<b>Fusha e përdorimit të pronës</b>	<b>Lloji i transferimit</b>
1-2	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative	Në pronësi
3, 4, 5, 7, 8, 9, 12, 13, 14, 16-21, 23, 25, 26, 28, 30-32	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka bujqësore produktive)	Në përdorim
6, 11, 15, 22, 24, 27, 142	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta)	Në pronësi
34-40, 83-85, 88-89	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
42-47	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën shërbimit funeral	Në pronësi
48-62	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
29, 75-82, 91	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
86, 90	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
92-114	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
115-122	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
123-126	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
149-152	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

**VENDIM**  
**Nr. 940, datë 26.12.2012**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR AUTORITETIN RRUGOR  
SHQIPTAR, TË MJEDISEVE DHE SIPËRFAQES 2735 M<sup>2</sup>, NGA TRUALLI FUNKSIONAL I  
PRONËS NR. 100, ME EMËRTIM “GRUP DEPO REP. USHT. NR. 5011/25”, TUJAN, TIRANË  
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË  
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI  
MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të mjediseve dhe sipërfaqes 2735 (dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) m<sup>2</sup> të truallit funksional të pronës nr. 100, me emërtim “Grup Depo Rep. Usht. nr. 5011/25”, me vendndodhje në Tujan, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas formularit standard të inventarizimit dhe planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur për nevoja urbanistike, ndërtimin e rrugës publike të Arbrit.

2. Mjediset dhe sipërfaqja 2735 (dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) m<sup>2</sup>, të truallit funksional të pronës nr. 100, me emërtim “Grup Depo Rep. Usht. nr. 5011/25”, Tujan, Tiranë, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose ta japin në përdorim te të tretët.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE**  
( Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta )

Ministria e Mbrojtjes

**Komuna Dajt, Tirane**

Fusha e përdorimit të pronës:

Per Mbrojtjen


A			B				C			
Nr	Zona Kadast Indeks i hartes	Numeri pasuris	Emerfesa e pronës Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te prones	Adresa/ vendodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne M2 ose MI	Funksioni per te cilin perdoret prona	Enti me Pergjegjesi Administrative	Enti Perdorues Statusi Juridik i përdorimit	Te dhena te tjera shenime te veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
<b>75</b>			<b>Komanda FT</b>			<b>17500 M2</b>	<b>Për Mbrojtjen</b>	<b>MM Rep.Usht. 8800 Tirane</b>	<b>Rep.Usht 8800 Tirane</b>	
			Qesarak, Tirane	Zyrat e komandes	Qesarak, Tirane	643				2 kate
				Zyrat e logarise		119				
				Postblloku		44				
				Batalioni Logjistik		176				
				Depo PH		192				
				Depo ushqimi		192				
				Depo		192				
				Depo		192				
				Truproje		114				







PLANVENDOSJA E REP. USHT. NR. 5011/25  
TUJAN (PRONA 100)





**VENDIM**  
**Nr. 941, datë 26.12.2012**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS GJOCAJ TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gjocaj të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Gjocaj të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr. 472, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Gjocaj, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Gjocaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Gjocaj, Elbasan

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6, 6/1	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
8	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore-historike dhe sportive	Në pronësi
9-30	Prona që përdoren për shërbime funerale	Në pronësi
31-87, 131, 132, 133, 134, 136, 137, 138	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (troje)	Në përdorim
88-91, 93, 94, 95, 97, 135	Prona që përdoren për realizimin e programeve të zhvillimit ekonomik	Në pronësi
98, 99, 104, 110, 111, 113, 114, 115, 118, 119, 122, 123, 124, 127, 128, 129, 139, 140, 142, 146 (Nuk transferohen sipërfaqet e përmendura në VKM-në nr. 868, datë 18.6.2008 “Për krijimin e kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore”: - 41 ha në fshatin Gjocaj; - 110 ha në fshatin Blinas; - 1.89 ha në fshatin Bardhas)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	
100, 101, 102, 103, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 112, 116, 117, 120, 121, 125, 126, 130, 143, 144, 145, 154, 159, 162, 170, 181, 184, 191, 196	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
199-255, 258-277, 279-363, 365-367, 370-389, 391-479, 482-587, 589-625	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
31-87, 131, 132, 141	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (sheshe)	Në pronësi

**VENDIM**  
**Nr. 942, datë 26.12.2012**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,  
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS  
TËRTHORE TË QARKUT TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Tërthore të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Tërthore të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr. 480, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Tërthore të qarkut të Kukësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Tërthore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Tërthore

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
8-9	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
10-134, 170-176, 178, 180-196, 224	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
136-169	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën zhvillimit ekonomik	Në pronësi
177, 179, 197-223, 225-256	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
263-265	Varrezat publike	Në pronësi
269-271, 273-274, 276-278, 280-281, 283-285	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
272, 275, 279, 282, 286	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi



**URDHËR**  
**Nr. 382, datë 31.12.2012**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për Ministrinë e Brendshme, Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Isuf Çelaj.
  2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 1 janar deri më datë 31 dhjetor 2013.
  3. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.
  4. Urdhri nr. 244/1, datë 15.11.2012 “Për delegim kompetencash”, revokohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BRENDSHËM**  
**Flamur Noka**

**VENDIM**  
**Nr. 60, datë 28.12.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtarë e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtarë e	“	“

me sekretarë Elta Milori, në datën 23.10.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 33 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Bashkim Sula, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokati Besnik Kaçurri.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Jorgo Harizi

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2011-125, datë 8.3.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 30 dhe 45/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Subjekti i interesuar, shtetasi Jorgo Harizi, që prej vitit 1961 ka qenë qiramarrës i rregullt i një apartamenti të ndodhur në Tiranë. Pas largimit të tij jashtë vendit, në vitin 1985, kontrata e tij e 10800

qirasë është zgjidhur nga ana e ish-Ndërmarrjes Komunale Banesa (NKB) dhe në vitin 1991 i është dhënë autorizimi për të lidhur kontratën e qirasë për këtë banesë kërkuesit Bashkim Sula.

2. Subjekti i interesuar i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt pavlefshmërinë e veprimit juridik të zgjidhjes së kontratës së qirasë dhe lirimim e banesës. Me vendimin nr. 4056, datë 27.10.1993, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kësaj padie me arsyetimin se *“paditësi nuk mund të trajtohet si emigrant ose refugjat, sepse është larguar në vitin 1985 dhe jo nga 2 korriku 1990 e këtej...”*. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 1144, datë 1.12.1993 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ai ka marrë formë të prerë.

3. Me kontratën nr. 177 rep. dhe 75 kol., datë 16.8.1994, shtetasit Bashkim dhe Drita Sula kanë blerë, nga ish-NKB-ja, apartamentin objekt konflikti gjyqësor, kontratë të cilën e kanë regjistruar edhe në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Tiranë.

4. Me vendimin nr. 5371, datë 9.11.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur njohjen e pavërtetësisë të dokumentit prokurë, të lëshuar në emër të avokatit A.K., me të cilën është realizuar përfaqësimi i shtetasit Jorgo Harizi në gjykimin e lartpërmendur, pasi ajo nuk është lëshuar dhe nënshkruar nga ky i fundit. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë.

5. Subjekti i interesuar, Jorgo Harizi, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve nr. 4056, datë 27.10.1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 1144, datë 1.12.1993 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Me vendimin nr. 60, datë 7.4.2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Ky shtetas i është drejtuar përsëri Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe me vendimin nr. 00-2007-1112 (24), datë 28.9.2007, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranim e kërkesës për rishikim, si të paraqitur jashtë afatit ligjor. Vendimi nr. 60, datë 7.4.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është bërë objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 58, datë 2.5.2008, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

6. Subjekti i interesuar, Jorgo Harizi, i është drejtuar përsëri me padi gjykatës me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes nr. 177 rep. dhe 75 kol., datë 16.8.1994, të lidhur midis shtetasve Bashkim dhe Drita Sula dhe ish-NKB-së, dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Sipas tij, ai është larguar nga Shqipëria si emigrant në vitin 1990 dhe, në këto kushte, kontrata e tij e qirasë për këtë banesë duhej të mbetej në fuqi, në bazë të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore.

7. Me vendimin nr. 2078, datë 17.3.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë.

8. Me vendimin nr. 741, datë 20.4.2010, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 2078, datë 17.3.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, duke e gjykuar çështjen në fakt: Pranimin e padsisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes të lidhur midis ish-NKB-së dhe Bashkim e Drita Sula dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.”* Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi Bashkim Sula.

9. Me vendimin nr. 00-2011-125, datë 8.3.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

**10. Kërkuesi Bashkim Sula** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën e datës 24.5.2012, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2011-125, datë 8.3.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke paraqitur këto argumente në mbrojtje të pretendimit të tij për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor:

10.1. Subjekti i interesuar, Jorgo Harizi, e ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore veprimin juridik të zgjidhjes së kontratës së qirasë nga ana e ish-NKB-së dhe, në lidhje me këtë padi, gjykatat kanë vendosur rrëzimin e saj, vendime që kanë marrë formë të prerë. Pas këtyre vendimeve, kërkuesi ka bërë rregullisht privatizimin e banesës dhe regjistrimin e saj në ZRPP.

10.2. Në rekurs janë paraqitur shkaqe ligjore që lidhen me zbatimin e keq të ligjit material, më konkretisht të Kodit Civil të vitit 1981 dhe të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore. Shkaqet ligjore



të ngritura në rekurs janë të tilla që kërkonin një përgjigje të argumentuar nga Gjykata e Lartë. Ajo duhej të kalonte çështjen në seancë gjyqësore dhe të mbante qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e kërkuarit.

**11. Subjekti i interesuar, Jorgo Harizi,** parashtron në argumentet e tij para Gjykatës Kushtetuese:

11.1. Kërkuari Bashkim Sula, duke shpërdoruar dhe abuzuar me të drejtën për akses në gjykatë dhe mjetet procedurale ligjore në dispozicion, ka investuar dy herë Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e së njëjtës çështje për të cilën kjo gjykatë është shprehur më parë me vendimin nr. 61, datë 9.6.2011. Në rast se parashtrimi i fakteve dhe i rrethanave juridike nga kërkuari do të kishte qenë i vërtetë dhe i saktë, kjo kërkesë nuk do duhej të pranohej për shqyrtim në seancë plenare, pasi në të paraqiten të njëjtat pretendime që janë marrë më parë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e lartpërmendur.

11.2. Edhe në lidhje me thelbin e pretendimeve të paraqitura, atyre u është dhënë përgjigje jo vetëm me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por edhe me vendimin nr. 00-2011-2116, datë 15.12.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, të cilat shprehen se në rastin konkret nuk ndodhemi para gjësë së gjykuar, pasi edhe pse vendimet kanë të njëjtat palë, objekti dhe baza ligjore e kërtimeve në to është krejtësisht e ndryshme.

## II

*A. Në lidhje me pretendimin e subjektit të interesuar për shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese të së njëjtës kërkesë dhe me të njëjtat pretendime*

12. Subjekti i interesuar, Jorgo Harizi, pretendon se pretendimet e ngritura nga kërkuari Bashkim Sula në kërkesën në shqyrtim janë marrë në shqyrtim më parë prej kësaj Gjykate dhe atyre u është dhënë përgjigje me vendim të arsyetuar.

13. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vëren se ky gjykim kushtetues është vënë në lëvizje nga kërkuari Bashkim Sula, me kërkesën e datës 24.5.2012, e cila ka për objekt kundërshtimin e vendimit nr. 00-2011-125, datë 8.3.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Gjykata konstaton se kërkuari i është drejtuar edhe më parë kësaj Gjykate me kërkesën e datës 13.4.2011, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 741, datë 20.4.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 125, datë 8.3.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me kërkesën e datës 13.4.2011, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 61, datë 9.6.2011, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare me arsyetimin se: *“Kërkuari pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt, sepse rihapja e procesit gjyqësor, pasi vendimi ka marrë formë të prerë dhe kërkuari ka qenë në gëzim të së drejtës së tij të njohur gjyqësisht, cenon parimin e sigurisë juridike si element i shtetit të së drejtës. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkesa nuk përmban pretendime që lidhen me procesin e rregullt ligjor. Objekti i gjykimit në të dyja proceset ka qenë i ndryshëm dhe për këtë arsye, me të drejtë, gjykatat kanë marrë në shqyrtim padinë e paraqitur nga paditësi në procesin e dytë gjyqësor. Pavarësisht se palët kanë qenë të njëjta, kërkimet e tyre kanë qenë të ndryshme, prandaj gjykatat kanë pasur detyrimin të shpreheshin lidhur me to. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk përmban pretendime që lidhen me elementet e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, para gjykatave të zakonshme.”*

14. Gjykata vëren se, në kërkesën e datës 13.4.2011 kërkuari ngrë pretendime për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar, si element i sigurisë juridike, dhe cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, të marrë në dhomë këshillimi. Në këtë kërkesë të dytë, në shqyrtim, kërkuari ka kërkuar vetëm shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe pretendon se në rekurs janë ngritur pretendime të tilla, të cilave u duhej dhënë përgjigje nga ajo gjykatë. Gjykata vëren, gjithashtu, se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuari ka pretenduar se me vendimin nr. 4056, datë 27.10.1993, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka dhënë përgjigje një padie të ngritur nga subjekti i interesuar, Jorgo Harizi, lidhur me pavlefshmërinë e veprimit juridik të zgjidhjes së kontratës së qirasë, vendim që ka marrë formë të prerë dhe, duke qenë se në padinë e dytë (procesi që kundërshtohet në Gjykatën Kushtetuese) gjenden të njëjtat elemente të padisë të gjykuara tashmë, në referim të nenit 451/a të KPC-së, ajo nuk mund të merrej më në shqyrtim nga gjykatat. Duke i krahasuar të dyja kërkesat e paraqitura nga kërkuari Bashkim Sula, Gjykata arrin në përfundimin se, në thelb, pretendimet e ngritura prej tij, në 10802



të dyja rastet, kanë të bëjnë me moszbatimin e parimit të gjësë së gjykuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

15. Gjykata, në praktikën e saj, ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 29, datë 21.12.2006; nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se në kërkesën e re, objekt i këtij gjykimi, kërkuesi nuk ka parashtuar asnjë shkak të ri apo argument shtesë për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se vendimi nr. 61, datë 9.6.2011, në të cilin është vlerësuar se pretendimet e ngritura nga kërkuesi janë haptazi të pabazuara dhe është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, përbën pengesë në aspektin kushtetues, për sa kohë që ajo ka mbajtur një qëndrim përfundimtar lidhur me të njëjtat shkaqe të cilat kërkuesi, në thelb, i ka ngritur përsëri në këtë kërkesë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha

#### VENDIM

Nr. 25, datë 24.12.2012

#### **PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 3, DATË 25.6.2011 TË KOMISIONIT SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE “PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DHE DOKUMENTET QË DUHET T’I BASHKËNGJITEN FORMULARIT TIP TË KËRKESËS”**

Në mbështetje të nenit 16 pika 1 të ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike

#### VENDOSI:

Në vendimin nr. 3, datë 25.6.2011 të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike, të bëhet kjo shtesë:

1. Në nenin 6 shtohet pika 5, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike nëpërmjet sekretariatit të tij siguron marrjen e dokumenteve të mësipërme për kërkuessit që janë pjesë e grupeve në nevojë.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE  
Blegina Kodra

10803



**VENDIM**  
**Nr. 30, datë 7.12.2012**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PROCEDURAT E DHËNIES DHE RINOVIMIT TË LICENCAVE PROFESIONALE PËR SUBJEKTET JURIDIKE E FIZIKE QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Në zbatim të nenit 14 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencave dhe të procedurave të aplikimit për licencë të personave fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari në sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, dhe rregullores së licencimit të ERRU-së, miratuar me vendim të KKRR-së, nr. 29, datë 8.12.2009, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, bëhen këto ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

a) Te neni 11 “Rinovimi i licencës”, fjalia e parafundit:

“Kriteret për marrjen e vendimit nga KKRRU-ja janë të njëjta si në rastin e licencimit”, shfuqizohet.

b) Pas nenit 11 shtohet neni 11/1, si më poshtë:

1. Në rastet e ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe/ose drejtuesit teknik, i licencuari duhet të aplikojë për rinovimin e licencës brenda 30 ditëve nga lindja e këtyre ndryshimeve.

Kërkesa për rinovimin e licencës duhet të shoqërohet me këto dokumente:

a) Në rastet e ndryshimit të drejtuesit ligjor:

- Ekstraktin e QKR-së plotësuar me administratorin e ri;

- CV e drejtuesit të ri ligjor;

- Dëshminë e penalitetit (formular aplikimi dhe fotokopje e dokumentit të identifikimit);

- Deklaratën me shkrim të drejtuesit ligjor, ku të deklarojë me përgjegjësi zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të nxjerra nga ERRU-ja, të standardeve shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit e të legjislacionit shqiptar në fuqi;

- Autorizimin nga pronari për drejtuesin ligjor, i cili jep të drejtën për të kryer të gjitha veprimtaritë për aplikimin dhe përdorimin e licencës përkatëse;

b) në rast të ndryshimit të drejtuesit teknik:

- CV e drejtuesit të ri teknik;

- Dëshminë e penalitetit (formular aplikimi dhe fotokopje e dokumentit të identifikimit);

- Deklaratën me shkrim të drejtuesit teknik, ku të deklarojë me përgjegjësi zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga ERRU-ja, të standardeve shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit e të legjislacionit shqiptar në fuqi;

- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë.

I licencuari përjashtohet nga detyrimi i pagesës së licencimit në rastet e rinovimit të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor/teknik.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**  
**Nr. 33, datë 11.12.2012**

**PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS GRAMSH**

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë ...”, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor operatorit sh.a. Ujësjiellës Gramsh me:  
Drejtues ligjor: z. Tajar Kadri Bici;  
Drejtues teknik: znj. Miranda Skënder Bici.
2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Gramsh autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:  
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
3. Zona e mbulimit të këtij operatori është bashkia Gramsh, komunat: Pishaj, Kodovjak, Kushove, Tunje, Sult.
4. Kjo licencë është e vlefshme deri në datën 2.12.2013, siç është parashikuar në vendimin nr. 25, datë 2.12.2009 të Komisionit Kombëtar Rregullator .

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**  
**Nr. 34, datë 11.12.2012**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UJËSJELLËS PËRMET**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

**VENDOSI:**

1. Të miratojë tarifat për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm për sh.a. Ujësjiellës Përmet, si më poshtë:  
- Për konsumatorët me matës:

	<b>Tarifë volumetrike lek/m<sup>3</sup></b>	<b>Tarifa fikse lek/muaj</b>
- Konsumator familjar	40	100;
- Institucione buxhetore	110	100;
- Ente private	120	200;
- Për konsumatorët familjarë pa matës	40	100.

2. Objektivat e rregullave të performancës të shoqërisë për vitin 2013:



- Uji pa të ardhura (humbjet) 36%;
  - Niveli i matjes 60%;
  - Kohëzgjatja e furnizimit 14 orë/ditë;
  - Eficenca e energjisë 1.5 kwh/ m<sup>3</sup>;
  - Efikasiteti i stafit 11 p/000 lidhje;
  - Mbulimi me ujë 65%;
  - Norma e arkëtimit 97%;
  - Cilësia e ujit (klor + koliform) sipas standardeve.
3. Pagesa rregullatore 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.
4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2013 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr. 35, datë 11.12.2012**

**PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për efekt të mbarimit të afatit operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë me:  
Drejtues ligjor: z. Bujar Xhevdet Meraj;  
Drejtues teknik: z. Bujar Xhevdet Meraj.
2. Operatori sh.a. UK Rrogozhinë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:  
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.  
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Rrogozhinë, komunat Sinaballaj, Gosë, Kryevidh, fshatrat: Ballaj, Zhabjak, Zashtik.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare deri në datën 10.12.2016.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
**Nr. 36, datë 17.12.2012**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK FIER**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë mbi vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. UK Fier tarifat si më poshtë:

a) Për shërbimin e furnizimit me ujë:

	<b>Tarifë volumetrike lek/m<sup>3</sup></b>	<b>Tarifë fikse lek/muaj/klient</b>
- Konsumator familjar	52	200;
- Institucione buxhetore	100	200;
- Ente private	120	200;
- Klientë të veçantë (industri)	70	-.
b) Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura:		
- Konsumator familjar	13	-;
- Institucione buxhetore	16	-;
- Ente private	18	-.

2. Objektivat e treguesve të performancës së shoqërisë për vitin 2013:

- Uji pa të ardhura (humbjet)	60%;
- Niveli i matjes	55%;
- Kohëzgjatja e furnizimit	22 orë/ditë;
- Eficenca e energjisë	0.53 kwh/m <sup>3</sup> ;
- Efikasiteti i stafit	4,2 staf/000 lidhje;
- Mbulimi me ujë	97%;
- Mbulimi me kanalizime	60%;
- Norma e arkëtimit	87%;
- Cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standardeve.

3. Paga rregullatore për sh.a. UK Fier do të jetë 1% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2013 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**VENDIM**

**Nr. 37, datë 21.12.2012**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK  
GJIROKASTËR QYTET**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë mbi vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. UK Gjirokastrë Qytet tarifat si më poshtë:

a) Për shërbimin e furnizimit me ujë:

	<b>Tarifë volumetrike lek/m<sup>3</sup></b>	<b>Tarifë fikse lek/muaj/klient</b>
- Konsumator familjar	38	50;
- Institucione buxhetore	112	50;
- Ente private	124	50;



b) Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura:

- Konsumator familjar	8	-;
- Institucione buxhetore	14	-;
- Ente private	14	-.

c) Shitje uji me shumicë 2.2.

2. Objektivat e treguesve të performancës së shoqërisë për vitin 2013:

- Uji pa të ardhura (humbjet)	60%;
- Niveli i matjes	15%;
- Kohëzgjatja e furnizimit	5 orë/ditë;
- Eficenca e energjisë	0.4 kwh/ m <sup>3</sup> ;
- Efikasiteti i stafit	6 p/000 lidhje;
- Mbulimi me ujë	91%;
- Mbulimi me kanalizime	70%;
- Norma e arkëtimit	90%;
- Cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standardeve.

3. Pagesa rregullatore për sh.a. UK Gjirokastrë Qytet do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2013 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

### **KËRKESË**

Shtetësja Xhilda Koka (Preza) kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Qemal Beshiri, i biri i Hysenit dhe i Naxhijes, i datëlindjes 11.3.1922.

**KËRKUESJA**  
**Xhilda Koka (Preza)**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 15.1.2013  
Doli nga shtypi më 16.1.2013

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 24 lekë